



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke marrë parasysh:**

1. Mandatin ligjor të përcaktuar në Nenin 23 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 7 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte.
3. Shtojcën A, pika D2 të Pasqyrës së Taksave, të miratuar nga ZRRE me datë 17.01.2006, në seancën e mbajtur me 01. prill 2009 nxori këtë:

**VENDIM**

- I. **Aprovohet lista e taksave** për shqyrtimin e aplikacioneve për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

**Arsyetim**

1. Bazuar në nenin 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo zyre ka mandatin që të mbledh taksat për shqyrtimin e aplikacioneve të cilat duhet të paguhen gjatë parashtrimit të aplikacioneve. Ndër aplikacionet që shqyrtohen është edhe aplikacioni për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte.
2. Gjithashtu neni 7.1 i Rregullës për procedurën e autorizimit përcakton se të gjithë aplikuesit për autorizim do t'i paguajnë ZRRE-së taksën për shpenzimet e veta administrative, në shumën e specifikuar me Vendimin e ZRRE-së.
3. Përcaktimit i shumës së taksave është bërë duke ju referuar Shtojcës A të Pasqyrës së Taksave dhe praktikave dhe përvojave të rregullatorëve regionale, dhe duket si më poshtë:

<b>Kapaciteti i Instaluar i Gjeneratorit të ri</b>	<b>Çmimi/Euro</b>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet deri 5 MW</i>	<i>1,500.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 5 MW deri 10 MW</i>	<i>3,000.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 10 MW deri 50 MW</i>	<i>5,000.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 50 MW deri 100 MW</i>	<i>7,000.00</i>
<i>Gjeneratori i ri me kapacitet mbi 100 MW deri 200 MW</i>	<i>20,000.00</i>



4. Nëse gjeneratori i ri do të ketë kapacitet të instaluar mbi 200 MW, atëherë taksa për shqyrtimin e aplikacionit do të përcaktohet me Vendim të Bordit e duke u bazuar në koston reale të ndërtimit të gjeneratorit.
5. Ky Vendim do të nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda 14 ditëve nga data e aprovimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar